



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 20.02.2026
Numër Protokolli: 923/2026

A.nr.2075/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi, dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.2075/2025, të datës 26.12.2025, të parashtruar nga ankuesi G.V përmes përfaqësuesit me autorizim, avokat Mentor Bogaj nga Prishtina, kundër organit të punësimit/Agjencia Pyjore e Kosovës në çështjen juridike “*shkelje e të drejtës në pagë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 20.02.2026, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2075/2025, e datës 26.12.2025, e parashtruar nga ankuesi G.V.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil G.V(*tutje referuar vetëm ankuesi*), më datë 26.12.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër protokolli 3533 të datës 23.10.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës, me pretendim ankimore që ti kthehet koeficienti sipas aktit të emërimit, si dhe në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbim Civil të klasifikohet si specialist pasi që grupi i specialisteve hynë në fushë të Pylltarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 09.01.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Agjencia Pyjore e Kosovës, ndërsa kjo e fundit më datë 27.01.2026 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritorie administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 8080/2025 të datës 26.12.2025 e parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim avokat Mentor Bogaj në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen me numër protokolli 3533 të datës 23.10.2025; Emalin datës 24.12.2025; Ankesën me numër protokolli 4011 të datës 03.12.2025; Akt emërimit të datës 31.01.2012; Ankesën pa date dhe numër të parashtruar nga ankuesi te organi i punësimit; Diplomën e datës 28.12.1994; Indeksën e ankuesit; Njoftimin me numër 211K-255 të datës 30.01.2025; Përgjigjen me numër 417 të datës 15.05.2024; Autorizimin e datës 19.09.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 09.01.2026; Përgjigjen në ankesë të datës 27.01.2026; Akt emërimit të datës 01.02.2012; Përgjigjen në ankesë të datës 23.10.2025; Listat e pagave për periudhën kohore Janar 2023 deri në Dhjetor 2025; Listën e datës 05.03.2024 lidhur me shqyrtimin e procesit për klasifikimin e vendeve të punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi që ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e **pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se ankuesi G.V është i punësuar në Agjencinë Pyjore të Kosovës, dhe se i njëjti sipas Akt emërimit me numër ZP-39/2012 të datës 31.01.2012, mbanë pozitën e punës “*Inxhinier i Pylltarisë*”, në Sektorin/Drejtorinë Koordinuese e APK-së në Prizren.

Me datë 16.10.2025 ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim ka parashtruar kërkesë tek organi i punësimit me pretendim se të njëjtit i është ulur koeficienti nga 7 në 5.1 me hyrjen në fuqi të Ligjit NR.08/L196 të Pagave në Sektorin Publik, si pretendim tjetër ankuesi ka se organi i punësimit të gjithë koleget të cilët mbajnë pozitë të njëjtit me ankuesin i ka sistemuar në kategorinë Specialist përveç ankuesit. Tutje me datë 23.10.2025 Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës përmes përgjigjes me numër protokolli 3533 ka sqaruar se me hyrjen e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik koeficienti është ekuivalentuar nga DMZP sipas kategorisë nga koeficienti sa ishte 7 në 5.1 sipas Ligjit të pagave për kategorinë profesional 2 ndërsa sa i përket përfshirjes në grupin e specialistëve DMZP nuk e ka bërë ekuivalentimin nga profesional 2 në grupin e specialistëve për shkak të mos nostrifikimit të diplomës mbi studimet jashtë vendit në këtë rast studimeve në Universitetin e Beogradit-Serbi.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me numër protokolli 3533 të datës 23.10.2025 të organit të punësimit, pretendon se me hyrjen në fuqi të ligjit Nr.08/-196 për Pagat në Sektorin Publik, ankuesit i është ulur koeficienti nga 7 në 5.1 pa asnjë njoftim apo vendim paraprak, dhe se në vitin 2024 kategorizimi nga profesional 2 në Specialist është bërë për krejt koleget e tij me titullin e njëjte të punës përveç ankuesit andaj i njëjti kërkon nga Këshilli i Pavarur që ti aprovohet në tërësi ankesa. Lidhur me shqyrtimin e pretendimit ankuesit lidhur me ndryshimin e koeficientit, Kolegji i Këshillit analizoi dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, me theks të veçantë nën 2 paragrafi 1 dhe 2 si dhe nën 14 paragrafi 3 ku parashihet se: ” **Neni 2:** 1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ëve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj”,

Neni 14: 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik...” referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10.6 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, ndërsa, klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil. Andaj marr parasysh akt emërimit e ankuesit Kolegji i Këshillit, konstaton se procedimi i pozitës së ankuesit në sistemin e ri të pagave, të krijuar sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nuk është si pasojë e klasifikimit të pozitës së tij të punës, në kuptim të ligjit material, gjegjësisht Ligjit përkatës për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores përkatëse për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, por si rezultat i zbatimit të Vendimit Nr.04/128 të datës 16.02.2023, të Qeverisë së Kosovës lidhur me ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë e që sipas listës së pagave ankuesi rezulton se paguhet sipas koeficientit I15, 5.1, ashtu siç është parapare në shtojcën 10.6 të ligjit të lartcekur se *kategoria profesionale 2 në : Ministrit, Agjenci të Pavarura, Agjenci dhe Rregullatore, Agjenci Ekzekutive dhe të Shërbimit Publik me numër rendor 19 dhe 20 janë përcaktuar me koeficient I15, 5.1*, andaj pretendimi i ankuesit lidhur me kthimin e koeficientit 7 sipas ligjit të vjetër të pagave është i pa bazuar.

Tutje kolegji i këshillit lidhur me pretendimin e ankuesit se grupi Specialistit hynë në edhe në fushën e Pylltarisë dhe se kolegeve të tjerë me pozitë të njëjtë i është njohur kjo e drejtë ndërsa ankuesit jo kolegji ju referua, nenit 38 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: “2. Pozitat në shërbimin civil ndahen në këto kategori: 2.1. Kategoria e lartë drejtuese që përfshin: sekretaren/in e përgjithshëm, drejtorin/i në përgjithshëm në agjenci të pavarur dhe rregullatore, drejtorin/in ekzekutiv dhe zëvendësdrejtorin/in e një agjencie ekzekutive, si dhe pozitat e barasvlershme me to; 2.2. Kategoria e mesme drejtuese që përfshin pozitën e drejtores/it të departamentit dhe pozitat e barasvlershme me të; 2.3. Kategoria e ulët drejtuese që përfshin pozitën e udhëheqëses/it të divizionit dhe pozitat e barasvlershme me të; **2.4. Kategoria e specialistëve që përfshin profesionistë në fusha që kërkojnë përgatitje specifike;** dhe 2.5. Kategoria profesionale që përfshin zyrtarët profesional”, kurse një kategorizim i njëjtë është paraparë edhe sipas nenit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, mirëpo kjo rregullore me nenin 8 ka përcaktuar se: “Kategoria e specialistëve është kategoria përgjegjëse për kryerjen e detyrave të veçanta profesionale që kërkojnë përgatitje specifike sipas fushave të përcaktuara në Shtojcën Nr. 1 të kësaj Rregulloreje”, e si rezultat i kësaj sipas Shtojcës Nr.1/4 të kësaj rregulloreje tek përshkrimi për klasën e specialistëve është paraparë: “Në këtë klasë vendosen pozitat e nivelit të lartë profesional me përgatitje specifike, të cilat kryejnë detyra që kërkojnë njohuri të thella profesionale. Mbajtësit e këtyre pozitave kryejnë një sërë detyrash të natyrës komplekse ose specifike në mënyrë individuale ose si udhëheqës ose anëtar i një ekipi. Mbajtësit e këtyre pozitave punojnë të pavarur dhe pa mbikëqyrje dhe mbështetje profesionale brenda udhëzimeve të përgjithshme lidhur me objektivat dhe afatet e përfundimit të detyrave”, ndërsa në kuadër të kësaj shtojce tek arsimi i kërkuar për pozitat e specialistëve është paraparë **Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor)** në fushat e inxhinierisë, planifikim hapësinor, arkitekturë, urbanizëm, gjeodezi, kimi, fizikë, matematikë, biologji, mjekësi, farmaci, biokimi, ekologji,

pylltari, bujqësi, veterinari, gjeografi, ambient, astronomi, astrofizikë, pa përfshirë drejtimet arsimore. Andaj duke pas parasysh se ankuesi posedon diplomën universitare përmes të cilës dëshmohet se ka filluar studimet në vitin 1984 ndërsa është diplomuar në vitin 1994 në Universitetin e Beogradit në drejtimin Inxhinier i Pylltarisë, kolegji ju referua Udhëzimit Administrativ (MASHT) 12/2018 Pranimit dhe Procedurat e njohjes së diplomave, gradave dhe kualifikimeve të shkollave të larta profesionale dhe universitare të fituara jashtë Republikës së Kosovës, i cili sipas nenit 3 paragrafi 16, dhe 16.1 ka përcaktuar se; 16. *Këtij udhëzimi nuk i nënshtrohet njohja dhe barasvlera e diplomave/ kualifikimeve, 16.1. Te fituara/ lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë të cilat kanë funksionuar në territorin administrativ të ish Jugosllavisë deri në vitin 1992.* Andaj kolegji i këshillit marr parasysh se ankuesi ka diplomuar në vitin 1994 dhe nostrifikimi i diplomës nuk mund të bëhet pasi që Kosova nuk ka Marrëveshje aktive ende me Serbi lidhur me njohjen e diplomave si pasojë e kësaj gjendje ankuesi nuk mund të hyjë në grupin e Specialist, prandaj pretendimi ankuesi i ankuesit për kategorizimin në grupin e specialisteve është i pa bazuar jo për shkak të mungesës së përgatitjes profesionale siç e parasheh Rregullorja QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil por për shkak të diplomës së fituar jashtë vendit të cilës është e pa notifikuar.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.NR.2075/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Përfaqësuesit me autorizim avokat Mentor Bogaj;
- Udhëheqësit të Njësive të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Pyjore të Kosovës, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.